



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.23/2018

Prishtinë, më 6 qershor 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Saranda Bogujevci, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Mirjeta Kalludra, Frashër Krasniqi dhe Albulena Balaj- Halimaj.

Stafi mbështetës i komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Jahja Lluka, ZKM-KQPZH; Prenk Gjetaj, KQPZH; Kushtrim Gara, KQPZH; Trëndelina Ramadani, RTK; Lumturie Beka “Kosova Info”; Valdete Morina, RTK; Valdete Berisha “Arbresh Info”, Mehmet Krasniqi “Ekonomia Online”, Adelina Hasani, Bledar Mustafa, KDI; Alban Bajrami, praktikant i Kuvendi të Kosovës dhe Teuta Prekazi, OKB DNJ.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Prezantimi në komision, lidhur me Planin e përbashkët të punës së Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 25 prill 2018, u miratua pa vërejtje.

2. Prezantimi në komision, lidhur me Planin e përbashkët të punës së Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur

Kryetarja, tha se kemi të pranishëm në komision përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, të cilët do të prezantojnë Planin e përbashkët të punës së Komisionit Qeveritarë për Persona të Zhdukur, dhe më pas, fjalën ia dha z. Jahja Lluka.

Jahja Lluka, tha se kemi mbajtur disa takime me aktorët që merren me çështjen e të zhdukurve dhe shumë shpejt do ta kemi edhe planin konkret. Po ashtu, kemi marrë për obligim realizimin e Rezolutës së Kuvendit, kemi formuar grupin punues për hartimin e koncept-dokumentit për ndryshimin e Ligjit për Persona të Zhdukur, dihet se familjarët e personave të zhdukur, shumica e tyre janë në gjendje të rëndë dhe si Qeveri do të bëjë përpjekje t'i ndihmojmë në çdo rast. Javën e kaluar kemi pasur një takim rajonal në Podgoricë për përgatitje të Samitit të Londrës dhe jemi marrë vesh që të kemi një draft, të cilin do ta nënshkruajnë të gjithë kryeministrat në Samitin e Londrës.

Ai tha se në Ballkan, deri më tani, janë 12000 persona të pagjetur. Kosova deri 70% ka arritur të zbardhë fatin e tyre, por kemi edhe 1650 persona për të cilët familjarët çdo ditë trokasin nëpër dyert e institucioneve. Ne do të jemi të barabartë edhe në ICMP, meqenëse më herët nuk kemi qenë në këtë organizatë. Në Samitin e Londrës do të insistojmë që Kryeministri të ketë mundësinë t'i paraqesë kërkesat tona, ju bëj thirrje që sa më parë të zgjedhim problemin e drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore, për arsye se në Institut kemi shumë probleme që lidhen drejtpërdrejt me çështjen e të zhdukurve.

Kryetarja pyeti: Si Kosovë, a kemi databazë dhe a jemi gati për të qenë prezent në Samitin e Londrës dhe çka mund të presim konkretisht nga Samiti i Londrës dhe a mundemi të ketë pengesa nga ana e Serbisë në këtë Samit?

Jahja Lluka, tha se është një marrëveshje rajonale, përfaqësuesit e Serbisë nuk kanë pasur ndonjë pengesë me ne. Përfaqësuesit e ICMP-së janë të gatshëm të ndërmjetësojnë, por ne jemi të interesuar të kemi drejtpërdrejt kontakt me Serbinë. Pra, si shtet, tha se jemi të gatshëm për Samitin, databazën nuk e kemi komplet, kemi arritur një marrëveshje me ICMP-në, që ata janë të gatshëm që t'i trajnojnë njerëzit. Po ashtu, ne do t'i bëjmë kërkesë Qeverisë, për të punësuar tre njerëz, të cilët do merren vetëm me këtë problem.

Teuta Haxhiu, tha se është një lajm i mirë fillimi i hartimit të koncept-dokumentit për ndryshimin e Ligjit për Persona të Zhdukur dhe është mirë që për punën që bëhet nga Komisioni Qeveritar, të na njoftoni përmes mekanizmave si komision dhe të marrin pjesë edhe deputetët gjatë punës në komision, në kuadër të Qeverisë. Ajo pyeti: Sa kohë i duhet Qeverisë për t'i vendosur të dhënat, për të pasur databazë dhe çka mundemi ne si komision të ndihmojmë në procesin e zgjedhjes së Drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore? Më duhet ta përmend rastin e Mejës dhe propozoj që ne të ftojmë në komision, Shoqatën e Mejës, por edhe përfaqësuesit e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, sepse ata kanë shumë ankesa për kompleksin në Mejë.

Saranda Bogujevci, sa i përket Samitit të Londrës, u tha se është bërë një dokument në Podgoricë, ku ka hyrë çështja e personave të pagjetur dhe do të nënshkruhet nga kryeministrat e vendeve të rajonit në Samit, a është e mundshme që ne si komision të shohim se çka është kërkuar me atë dokument, sa i përket personave të pagjetur? Lidhur me çështjen e ICMP-së, a është filluar procesi për anëtarësim dhe cilat janë kriteret dhe a është diskutuar me ICMP-në kjo mundësi? Edhe në rezolutë është përmendur se cilat institucione, p.sh. Instituti i Mjekësisë Ligjore t'i plotësojnë vendet e punës, që të mund të ecin punët më mirë dhe është kërkuar që përveç fillimit të punës në databazë, të bëhet edhe skanimi i dokumenteve. Ne, si komision, do të mundohemi të ndihmojmë, aq sa mundemi në këtë proces.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se te pika 3.1 e këtij draft-plani të punës, ku është dialogu me Serbinë, keni parapa platformën e Qeverisë për dialog. Me sa e dimë, platforma veç është në përfundim. Sa do të jetë mundësia që ju të vendosni në platformë çështjen e personave të zhdukur? Te pika 2, sigurimi i informatave të reja dhe adresimi i mëtejshëm në kuptimin e gërmimit vlerësues dhe pika 2.1.2, inicimi i të gjitha lokacioneve të shënuara sipas listës që e keni, duke filluar nga tri lokacionet e papërfunduara në vitin 2017, a ekzistojnë nëpër komuna zyrtarët komunalë për çështjen e personave të zhdukur dhe a keni pasur koordinim me partnerët ndërkombëtarë për lokacionet në territorin e Serbisë?

Miljana Nikoloq, u ankua, sepse dokumentet që po shqyrtohen në këtë mbledhje nuk janë të përkthyer në gjuhën serbe.

Administrata e komisionit njoftoi se dokumentet i kemi kërkuar nga Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, por ata nuk i kanë dërguar, madje as kopjen në gjuhën shqipe nuk e kemi pranuar më parë, por një kopje na e dorëzuan në këtë mbledhje.

Kryetarja, tha se në Kuvendin e Kosovës po përballemi me mungesë të përkthyesve në gjuhën serbe dhe se tani është shpallur një konkurs për pranimin e përkthyesve të rinj dhe shumë shpejt do të eliminohet problemi i përkthimit.

Jahja Lluka, tha se sa i përket koncept-dokumentit, kur ti' vijë koha, pas seancave punuese, do të kemi një takim të përbashkët, para se të sillen projektligji në Kuvend. Sa i përket dokumentit të Samitit, janë tri versione dhe kur ta kemi versionin përfundimtar, do t'ua sjellim juve me sugjerimet tona dhe keni mundësi edhe ju t'i jepni sugjerimet e juaja. Sa i përket

drejtorit të Institutit, kjo çështje i përket Qeverisë, por ju si deputetë në Kuvend mund të ngrini zërin, pse nuk është zgjidhur ky problem. Platforma është tërhequr nga Kuvendi, me qëllim që t'u jepet mundësia juve që ta krijoni platformën.

Kryetarja, tha se si komision do të insistojmë që një anëtar i komisionit tonë, të jetë prezent në Londër, nëse nuk keni diçka kundër.

Kushtrim Gara, tha se zyrtarët komunalë për çështjen e personave të zhdukur, ka qenë e vetmja Komuna e Gjakovës që në kuadër të organogramit e ka pasur këtë zyrtar, disa komuna e kanë ngarkuar një zyrtar tjetër edhe me këtë detyrë. Sa i përket databazës, në përputhje me ligjin, Komisioni Qeveritar, në vitin 2012, ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, i cili ofron si donacion për Komisionin Qeveritar softuerin e bazës së të dhënave. Me përkrahjen edhe të Ambasadës së Britanisë së Madhe, përmes projektit të UNDP-së, me investim edhe të shtetit të Kosovës, është arritur që të regjistrohen të gjitha të dhënat për rastet e hapura të personave të zhdukur. Siç është e paraparë edhe në plan, janë të shënuara 10 lokacione, brenda territorit të Kosovës, të cilat do të jenë pjesë e agjendës për punë, në këtë vit.

Lirije Kajtazi, meqë pashë gatishmërinë për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit, të merremi vesh që së paku në tre muaj të raportoni kështu për progresin në respektimin dhe zbatimin e rezolutës. EULX-i është dashur t'i dorëzohë dosjet deri në qershor të ju. Dua të di, a i ka dorëzuar dhe ku ka mbetur procesi i përmbylljes së morgut?

Jahja Lluka, sa i përket morgut, kemi arritur marrëveshjen me Komunën e Prishtinës për lokacion në lagjen Mirdita.

Kryetarja, tha se para disa ditësh ne kishim në takim drejtorin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, do ti ftojme edhe përfaqësuesit e Shoqatës "27 Prilli" nga Gjakova dhe më pas do të shkojmë ta vizitojmë edhe për së afërmi Kompleksin Memorial në Mejë.

4. Të ndryshme

Saranda Bogujevci, njoftoi se ishte në një trajnim në Hagë, organizuar nga Universiteti i Oxford-it, një trajnim i tillë është bërë edhe në Oxford dhe tha se ka biseduar me palët organizatore, për të bërë diçka të ngjashme në Kuvend dhe ata kanë shprehur gatishmërinë. Unë mendoj se kjo do të duhej të bëhet përmes Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Komisionit për Legjislacion. Ajo tha se do ta bëjë kërkesën për Kryesinë e Kuvendit, në emër të Komisionit funksional.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se duhet të vendosim për vizitën në Maqedoni, të takohemi me Kryetarin e Kuvendit, komisionin homolog të Kuvendit të Maqedonisë dhe kryetaren e Komunës së Tetovës, zëvendëskryeministrin dhe me Klubin e Grave Deputete të Kuvendit të Maqedonisë.

Kryetarja konstatoi se komisioni vendosi të realizojë vizitën në Maqedoni dhe të fillojnë procedurat për këtë vizitë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje